

I. Çfarë është Prokurimi Publik

Me prokurim publik do të kuptojmë blerjen e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.

Ligji i ri i miratuar për Prokurimin Publik (Nr. 162, datë 23.12.2020) dhe Rregulloret e nxjerra në zbatim të këtij Ligji bënë të mundur që Republika e Shqipërisë të ketë një regjim më të hapur dhe transparent të prokurimit publik, në përputhje me Praktikën më të Mirë Ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Europian.

Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit dhe veprimtaria e saj bazohet në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligjin nr.125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat” dhe Ligjin nr.9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Ligji i ri kombëtar i Prokurimit Publik, së bashku me Rregulloret e Prokurimit dhe Manualin e Prokurimit përcaktojnë kuadrin administrativ për procedurat e prokurimit publik në Shqipëri. Ligji zbatohet për të gjitha procedurat e përzgjedhjes për furnizimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve publike, të cilat janë të zbatueshme si për Autoritetet Kontraktore (AK) ashtu edhe Operatorët Ekonomikë.

Qëllimi i ligjit të ri të prokurimit publik synon që të:

- i. Sigurohet një përdorim më i mirë i fondeve publike dhe pakësimi i kostos procedurale;
- ii. Inkurajohen Operatorët Ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik;
- iii. Nxisë konkurrencën ndërmjet Operatorëve Ekonomikë;
- iv. Garantojë një trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për gjithë Operatorët Ekonomikë që marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik;
- v. Garantojë integritet, besimin publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

II. Llojet e Procedurave Standarde të Prokurimit Publik

Në zbatim të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktor zbaton procedurat e prokurimeve si më poshtë:

- a) procedurë e hapur;
- b) procedurë e kufizuar;
- c) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
- d) partneritet për inovacion;
- e) dialogu konkurrues;
- f) procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;
- g) procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;

- h) *procedurë e hapur e thjeshtuar*;
- i) shërbim konsulence.

Per subjektet juridic te cilet ushtrojne veprimtari ekonomike ne sektorin e ekonomise blu, pergjithesisht zbatohen procedura e hapur e thjeshtuar dhe procedura me vlere te vogel,

i. Procedura e hapur e thjeshtuar

Shërbimet me veprimtaritë e ofruara nga subjektet që operojnë në ekonominë blu përkojnë me procedurën e hapur të thjeshtuar prokurimit publik, kufiri i ulët monetar i së cilës është më e lartë se 1,000,000 (një milion) lekë.

Me procedurë të hapur të thjeshtuar kuptojmë konkurrimin e operatorëve ekonomik me një fazë, ku mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar. Për këtë procedurë, kur vlera e kontratës është ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave nga Autoriteti Kontraktor është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.¹

Autoriteti Kontraktor përpilon dokumentat e tenderit të cilat mund të aksesohen nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit publik. Në dokumentin e emërtuar “Dokumentat Standarde të Tenderit” paraqiten të detajuara informacionet mbi procedurën respektive, formularët tip që duhen plotësuar si dhe dokumentat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomik pjesëmarrës.

ii. Procedura me Vlerë të Vogël

Autoriteti ose Enti Kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për mallra, shërbime dhe punë, vlera e përlogaritur e të cilave gjatë vitit kalendarik është nga 100,000 (njëqind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milion) lekë, pa përfshirë TVSH-në.

Në Procedurën me Vlerë të Vogël, Autoriteti Kontraktor paraqet nëpërmjet sistemit të prokurimit Ftesën për Ofertë e cila përmban përshkrimin e detajuar të shërbimit objekt prokurimi si dhe kërkesat e dokumentacionit që duhet të paraqiten nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës.

Nga momenti i publikimit të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor, Operatori Ekonomik duhet të përgatisë dokumentacionin përkatës dhe ta ngarkojë atë në system brenda afatit të percaktuar i cili mund të jete nga 24 ore deri në 5 dite

III. Aktorët Kryesor në Prokurimin Publik

Në interpretim të Ligjit për Prokurimin Publik, evidentohen si aktorë kryesor:

- a) Agjencia e Prokurimit publik, detyrat dhe kompetencat e së cilës fokusohen kryesisht në:
 - Përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumentave Standarte të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura;

¹ Kufiri i ulët monetar: 8.000.000 (tetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

- Verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës dhe në rast shkeljesh të dispozitave ligjore dhe nënligjore, vendosjen e gjobave ose propozimin e marrjes së masave administrative;
- Monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, si dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private;
- Hartimin dhe nxjerrjen e Buletinit të Njoftimeve Publike;
- Përrjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionare apo të ankandit publik për një periudhë nga një deri në tre vjet;
- Nxitjen dhe organizimin e kualifikimit të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit. Ndaj ankesave të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit merr vendime dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme.

Autoriteti Kontraktor është çdo ent që i nënshtrohet ligjit për zbatimin e kontratave të tij publike, të tilla si institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, çdo ent i themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar, organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete.

Operator Ekonomik është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre.

IV. Aksesin në Platformën Agjencisë së Prokurimit Publik

Në mënyrë që Operatorët Ekonomik të mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit, është e nevojshme që fillimisht të regjistrohen në platformën qeveritare www.app.gov.al

Për këtë qëllim, çdo Operator Ekonomik mund t'i drejtohet me shkresë zyrtare Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila krijon llogarinë elektronike të operatorit në portal dhe i vendos këtij të fundit në dispozicion kredencialet për të aksesuar sistemin.

Pasi Operatori Ekonomik të ketë akses në sistemin e prokurimit, ai mund të kërkojë prokurimet aktive nga Autoritetet Kontraktore si dhe të nis procesin e aplikimit për garën respective.

V. Përgatitja e Dokumentacionit për Prokurimin Publik të shpallur

Në Portalin e Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktor publikon garën specifike së bashku me dokumentat e kërkuara për t'u paraqitur nga Operatorët Ekonomik. Gara e publikuar shoqërohet

me dokumentin e Njoftimit / Proçesverbalit sëbashku me kërkesat dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomik të cilët synojnë të marrin pjesë.

Në mënyrë të përmbledhur, dokumentacioni që kërkohet nga Autoritetet Kontraktore, përgjithësisht konsiston në paraqitjen e dokumentacionit ligjor të regjistrimit të subjektit, vërtetime nga autoritetet publike mbi shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, taksa vendore, tatime dhe contribute shoqërore si dhe formularët e vetë-deklarimit të cilat janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor dhe duhen nënshkruar nga OE.

Krahas dokumentacionit ligjor, AK rezervon të drejtën që të kërkojë nga OE të paraqesin gjithashtu leje/licenca që disponojnë për ofrimin e shërbimit objekt prokurimi.

VI. Hapja dhe Vlerësimi i Ofertave nga Autoriteti Kontraktor

Në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, Autoriteti Kontraktor realizon hapjen e ofertave të paraqitura nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në prokurimin konkret. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit me një afat prej 7 (shtatë) ditësh. Pasi të plotësohet afati për ankimin, Autoriteti Kontraktor vijon me nënshkrimin e marrëveshjes me Operatorin Ekonomik të përzgjedhur si fitues.

Në procedurën me Vlerë të Vogël, Autoriteti Kontraktor realizon hapjen e ofertave të paraqitura nga Operatorët Ekonomik. Afati minimal i përcaktuar në ftesën për ofertë për hapjen dhe pranimin e ofertave është përcaktuar të paktën 24 orë nga publikimi i Ftesës për Ofertë në sistemin e prokurimit publik.

Klasifikimi përfundimtar i Operatorëve Ekonomik realizohet bazuar në kriterin e çmimit më të ulët.

Vlen të theksohet se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e refuzimit të ofertës së paraqitur kur:

- a) Operatori Ekonomik nuk ka si objekt të veprimtarisë objektin e prokurimit;
- b) Operatori Ekonomik në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga po ky Autoritet Kontraktor, nuk është paraqitur brenda afatit kohor për të realizuar objektin e prokurimit;
- c) Operatori Ekonomik paraqet ofertë të ulur prej më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të fondit limit.

VII. Procedura e Ankimit

Në procedurën e hapur të thjeshtuar, Operatori Ekonomik dërgon njëkohësisht ankesën në Autoritetin Kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesës nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik, Operatori Ekonomik ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative kompetente për të shqyrtuar mosmarrëveshjen.

Në Procedurën me Vlerë të Vogël Operatorët ekonomikë të cilët janë refuzuar ose ata që janë renditur deri në vendin e dhjetë, kanë të drejtën të ankohen vetëm pranë Autoritetit Kontraktor brenda 2 (dy) ditëve nga konfirmimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

Pasi merr dijeni për ankesën e drejtuar, Autoriteti Kontraktor pezullon vijimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës/ave nga një person i cili nuk ka qenë më parë i përfshirë në procedurën në fjalë. Punonjësi i caktuar për shqyrtimin e ankesës, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e ankesës duhet të shprehet me vendimin për pranim ose refuzim të ankesës duke j'ua dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Kundër këtij vendimi, Operatori Ekonomik ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative kompetente për të shqyrtuar mosmarrëveshjen.

Referencat:

Ligji nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”

Udhëzimi nr.05, datë 25.06.2021 “Mbi Përdorimin e Procedurës me Vlerë të Vogël dhe Zhvillimin e Saj me Mjete Elektronike”